



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të neneve 11, 12 par.12.2 shkronja c), 16 dhe 17 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 Qershor 2008, nenit 9 shkronja f), o) dhe p), dhe 20 shkronja c) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur e me 29. 07. 2016, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratoj këtë :

RREGULLORE PËR SHËRBIMET PUBLIKE DHE RENDIN KOMUNAL

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohen përgjegjësitë dhe obligimet e ndërmarrjeve që ofrojnë shërbime publike për qytetarë në teritorin e Komunës së Lipjanit dhe obligimet e qytetarëve dhe bizneseve në ruajtjen e rendit komunal, masat dhe aktivitetet për menaxhimin dhe ruajtjen e sipërfaqëve publike si dhe obligimet dhe përgjegjësitë e qytetarëve dhe bizneseve në ruajtjen e rendit komunal dhe mirëmbajtjes së pastërtisë.

Neni 2 Fushëveprimi

Kjo Rregullore zbatohet ndaj të gjitha subjekteve dhe bizneseve që ofrojnë shërbime publike komunale, që ushtrojnë veprimtari afariste dhe ndaj qytetarëve lidhur me obligimet dhe përgjegjësitë për ruajtjen e rendit komunal dhe mirëmbajtjes së pastërtisë.

Neni 3 Përkufizimet

Termet e përdorura në kuptim të kësaj Rregulloreje kanë kuptimin, si vijon:

1. Ofrues i shërbimeve publike – të gjitha ndërmarrjet të cilat ofrojnë shërbime për qytetarë përkitazi me: furnizim me ujë, rrymë elektrike, shërbime të post-telekomunikacionit, mirëmbajtje të sipërfaqëve publike, tregjeve, rrugëve, ndriçimi publik dhe mirëmbajtjes së pastërtisë.

2. Sipërfaqe publike – të gjitha sipërfaqet publike në pronësi të Komunës, si vijon: rrugët, trotuarët, sheshet, hapësirat për parking, sipërfaqet publike të gjelbëruara, terrenet sportive, tregjet dhe varrezat.

3. Shërbimet publike komunale, në kuptim të kësaj Rregulloreje konsiderohen:

3.1 furnizimi me ujë;

3.2 përcjellja dhe pastrimi i ujërave të zeza dhe atmosferike;

3.3 rregullimi dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbëruara publike;

3.4 pastrimi i sipërfaqeve publike në vendbanime;

3.5 bartja, deponimi dhe përpunimi i mbeturinave;

3.6 mirëmbajtja dhe rregullimi i sipërfaqeve publike;

3.7 ndriçimi publik;

3.8 rregullimi dhe mirëmbajtja e objekteve sportive dhe

3.9 sinjalizimi dhe numërizimi i rrugëve, shesheve dhe hapësirave tjera publike.

4. Mirëmbajtja e përmendoreve, shtatoreve, busteve, simboleve, varrezave, transporti lokal dhe shfrytëzimi i sipërfaqeve publike rregullohen me rregullore të veçanta.

5. Objektet komunale publike në kuptim të kësaj Rregulloreje konsiderohen:

5.1 rrjeti i tërësishëm i ujësjellësit dhe kanalizimit me të gjitha pajisjet përcjellëse,

5.2 rrugët, trotuarët dhe sheshet,

5.3 hapësirat për parking,

5.4 sipërfaqet publike.

5.5 terrenet sportive,

5.6 përmendoret, shtatore, bustet, simbolet dhe varrezat,

5.7 rrjeti i ndriçimit publik me stabilimentet përcjellëse,

5.8 tabelat për shpallje,

5.9 të gjitha objektet tjera të cilat sipas destinimit që kanë mund të konsiderohen objekte komunale.

II. PËRGJEGJËSIT DHE OBLIGIMET PER OFRIMIN E SHERBIMEVE PUBLIKE DHE RENDIN KOMUNAL

Neni 4

Obligimet e Komunës për ofrimin e shërbimeve publike

1. Komuna për çdo vit kalendarik, me rastin e miratimit të buxhetit të Komunës, planifikon mjete me destinime të veçanta për zbatimin e procedurave të prokurimit në ofrimin e shërbimeve publike nga kompetenca e Komunës.

2. Komuna kujdeset që ndërmarrjet që ofrojnë shërbime publike të përzgjedhura sipas procedurave të prokurimit të ofrojnë shërbime publike në kualitet dhe cilësi ashtu siq është përcaktuar me kontratën mbi ofrimin e shërbimeve.

Neni 5

Obligimet dhe përgjegjësitë e ndërmarrjeve dhe subjekteve të biznesit të cilat ofrojnë shërbime Publike

1. Ndërmarrjet të përzgjedhura me procedura të prokurimit të cilat ofrojnë shërbime publike janë të obliguara që këto shërbime ti ofrojnë në mënyrë profesionale, me kualitet dhe cilësi të përcaktuara sipas standardeve dhe kontratave për ofrimin e shërbimeve.

2. Subjektet nga paragrafi 1 janë të obliguara që të përdorin mjete të përshtatshme sipas standardeve për ofrimin e shërbimeve publike, të mirëmbajnë stabilimentet dhe me kohë ti sanojnë defektet eventuale.

Neni 6

Obligimet e qytetarëve dhe bizneseve për ofrimin e shërbimeve publike

1. Qytetarët dhe bizneset të cilët operojnë në Komunën e Lipjanit kanë për obligim që gjatë ushtrimit të veprimtarive të tyre ti ruajnë dhe mos ti dtojnë stabilimentet dhe mjetet për ofrimin e shërbimeve publike.

2. Qytetarët dhe bizneset janë të obliguar që me kohë ti përmbushin obligimet financiare të përcaktuara sipas tarifave për ofrimin e shërbimeve publike.

Neni 7

Ujësjellësi dhe kanalizimi

1. Ndërmarrjet, detyrë e të cilave është furnizimi i rregullt i qytetarëve me ujë të pijshëm, përpunimi, pastrimi dhe përcjellja e ujërave të zeza dhe atmosferike, bëjnë shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e objekteve dhe pajisjeve të parapara sipas nenit 3 të kësaj rregulloreje, gjegjësisht:

1.1 bëjnë mirëmbajtjen dhe sigurimin e rregullt të të gjitha objekteve, pajisjeve dhe instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit,

1.2 bëjnë kontrollimin e përhershëm të cilësisë së ujit të pijshëm, për sigurimin e pandërprerë të rregullsisë higjienike - teknike të ujit të pijes, sipas dispozitave ligjore për këtë lëmi,

1.3 japin kushtet për sigurimin e lidhjeve në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit, dhe

1.4 bëjnë pastrimin e të gjitha pusetave akumuluese dhe të pusetave për ujërat atmosferike dhe ujërave të zeza, një herë në vit.

Neni 8

Mbikëqyrja e cilësisë së ujit

1. Mbikëqyrjen e cilësisë së ujit e bënë organi kompetent sanitar, sipas dispozitave ligjore dhe i ndërmerr masat me të cilat sigurohet cilësia e kërkuar.

2. Vlerësimin për cilësinë e ujit mund ta jep laboratorin e ndërmarrjes publike, të cilës i janë besuar punët dhe Enti i autorizuar shëndetësor.

Neni 9

Furnizimi me ujë

1. Ndërmarrja së cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe kanalizimit, është e obliguar që shfrytëzuesve t'u sigurojë rregullisht ujë të pijshëm dhe me kualitet.

2. Obligimet nga paragrafi paraprak pushojnë në këto raste:

2.1 Ka mendim të arsyeshëm se vazhdimi i ofrimit të shërbimeve të ujësjellësit paraqet rrezik të drejtpërdrejtë për jetën a shëndetin e cilit do person fizik,

2.2 Një ndërprerje e tillë kërkohet për qëllime operacionale apo të mirëmbajtjes,

2.3 Kërkesa për ujë e tejkalon ofertën.

3. Ndërprerjet e shërbimeve bëhen në qoftë se janë ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme për largimin e rrezikut ndaj jetës apo shëndetit të personave të rrezikuar të shkaktuar nga ndërprerja e tillë dhe në rastin e paraparë në nën parag. 2.3 të këtij neni, që ndërprerje e tillë është bërë vetëm pasi që ofruesi i shërbimeve ka kursyer ujin në dispozicion në mënyrën më të mirë të mundshme në bazë të aftësisë së tij teknike.

4. Me rastin e ndërprerjeve lokale të planifikuara më parë të furnizimit me ujë, shfrytëzuesit duhet të njoftohen së paku 24 orë më herët me datën, kohën dhe zgjatjen e ndërprerjes.

Neni 10

Furnizimi me ujë i objekteve

Çdo objekt publik, dhe kolektiv, duhet të jetë i furnizuar me ujë nga ujësjellësi publik i qytetit dhe patjetër ta ketë lidhjen e veçantë të ujësjellësit-ujëmatësin dhe rrjetin e veçantë të kanalizimeve.

Neni 11

Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit

Ndërmarrja, së cilës i besohen punët e mirëmbajtjes së rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, do ta mirëmbajë rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit, bashkë me nyjat përcjellëse të ujëmatësit, respektivisht deri te objekti i parë akumulues i pusëtës.

Neni 12

Kyqja në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit

Pronarët e nyjeve sanitare me gropa septike janë të obliguar që të bëjnë kyqjen menjëherë në nyjat e rrjetit të kanalizimit më së voni në afatin prej 3 muajsh pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje nëse ekziston rrjeti i kanalizimit.

Neni 13

Leja për kyqje

Lejen për lidhje në nyjën përcjellëse në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit e lëshon ndërmarrja së cilës i janë besuar punët.

Neni 14

Matja e ujit të shpenzuar

1. Matja e ujit të shpenzuar nga rrjeti publik i ujësjellësit, duhet të kryhet vetëm përmes ujëmatësit.

2. Në rast të prishjes së ujëmatësit, ndërmarrja së cilës i besohen punët e mirëmbajtjes së tyre, do të caktojë shumën e paragjykuar (paushall) të pagesës së mesatares së tremujorit të fundit, deri të kthehet ujëmatësi i rregulluar (ose i ri).

3. Pronarët e objekteve me rrjet të ujësjellësit në të cilin shpenzimet e ujit paguhen në mënyrë të paragjykuar, janë të obliguar që në afatin prej 60 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, me shpenzimet e veta ta vendosin ujëmatësin në rrjetin e vet, nëse lejojnë kushtet teknike.

4. Nëse shfrytëzuesi i ri i ujëmatësit nuk e vendos ujëmatësin, ndërmarrja e autorizuar menjëherë do ta shkyç shfrytëzuesin e ri nga ujësjellësi publik.

Neni 15

Vendosja dhe riparimi i ujëmatësve

1. Vendosjen, respektivisht montimin e ujëmatësve dhe ndërrimin e të vjetrave e bënë ekskluzivisht ndërmarrja së cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit dhe atë në afat prej 45 ditësh nga dita e paraqitjes nga ana e pronarit.

2. Vendosja e ujëmatësit të rinj, riparimi dhe ndërrimi i ujëmatësve të vjetër bëhet me shpenzimet e shfrytëzuesve të ujëmatësve.

3. Ujëmatësit patjetër duhet të jenë të mbrojtur sipas standardeve të pranueshme dhe të vendosur në vendet e veçanta dhe të mbyllura, të cilat ndërtohen me shpenzimet e investitorit, respektivisht të pronarit të objektit në bazë të udhëzimeve të ndërmarrjes së cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit.

4. Çdo prishje dhe dëmtim të ujëmatësve, konsumatori është i obliguar që menjëherë ta paraqes te ndërmarrja së cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit dhe ndërmarrja është e detyruar që këtë prishje dhe dëmtim ta sanojë në afatin prej 24 orësh.

5. Riparimin e ujëmatësit mund ta bëjë vetëm ndërmarrja e autorizuar, të cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit.

6. Konsumatorët dhe shfrytëzuesit e ujësjellësit publik, janë të detyruar që me kohë të ndërmarrin masa që instalimet e shtëpive të mbrohen nga prishjet, ngricat dhe të mbahen gjithnjë në gjendje të rregullt.

Neni 16

Tarifat për shërbime

1. Për shfrytëzimin e ujit dhe të shërbimeve nga rrjeti i ujësjellësit dhe i kanalizimit paguhet kompensimi nga ana e konsumatorëve për ndërmarrjen e ujësjellësit dhe kanalizimit.

2. Tarifën mbi lartësinë e këtij kompensimi e cakton Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit, nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Neni 17

Bazat për ndërprerje dhe ri lidhja në rrjetin e ujësjellësit

Shkyqja nga rrjeti i ujësjellësit, procedurat e ndërprerjes, lidhjet e paautorizuara, ri lidhja e bërë nga ofruesi i shërbimeve, lidhjet e paautorizuara dhe manipulimi me ujëmatës përcaktohen sipas Ligjit për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit.

Neni 18

Kufizimet në shpenzimet e ujit

1. Ndërmarrja së cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit, është e obliguar që ta pengojë çdo derdhje të ujit pa arsye dhe të kërkojë të ndërmerren masa ndëshkimore në pajtim me këtë Rregullore dhe akteve tjera ligjore.
2. Në raste të thatësisë dhe pengesave tjera të furnizimit me ujin e pijes, ndërmarrja së cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit, është e obliguar që të ndërmerr masa teknike të kufizimit të shpenzimit të ujit.
3. Në këto raste ndërmarrja nga paragrafi paraprak do t'i propozojë organeve përkatëse të administratës komunale, që me Urdhëresë të veçantë të caktojë mënyrën e shpenzimit të ujit, kufizimit ose ndalimin e shpenzimit të ujit, për disa konsumatorë të caktuar. Urdhëresën e zbaton ndërmarrja dhe inspektori komunal.

Neni 19

Furnizimi me ujë nga hidrantët publik

1. Përmes hidrantëve të rrjetit të ujësjellësit publik, ujin mund ta marrin vetëm ndërmarrjet dhe subjektet tjera, të cilat për këtë e kanë pëlqimin paraprak nga ndërmarrja, të cilës i janë besuar punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit, në koordinim me organin kompetent komunal.
2. Njësia e zjarrfikësve ka të drejtë të marrë ujin nga ujësjellësi publik gjatë intervenimit në fikjen e zjarreve.

Neni 20

Sipërfaqet publike

1. Sipërfaqet publike, sipas kësaj Rregulloreje, konsiderohen:
 - 1.1 Sipërfaqet e trafikut publik (rrugët dhe sipërfaqet tjera për trafik, trotualet, rrugicat dhe sipërfaqet tjera publike),
 - 1.2 Stacionet e autobusëve, vendqëndrimet dhe hapësirat për parkim,
 - 1.3 Sipërfaqet publike dhe të gjelbërta, (parqet, sheshet e vogla, drurët, sipërfaqet me bari, sipërfaqet për pushim dhe rekreacion),
 - 1.4 Terrenet argëtuese dhe sportive (stadiumet, fushat e sportit, çerdhet etj),
 - 1.5 Sipërfaqet me ujë, brigjet afër lumit etj,
 - 1.6 Tregjet,

1.7 Sipërfaqet e hapura ndërmjet dhe rreth banesave, si dhe tokat e pa ndërtuara (trojet, vendet për shkarkim dhe oborret), fasadat, kulmet e ndërtesave të banimit,

1.8 Sallat e kinemave, teatrove dhe të tjera, të cilat shërbejnë për tubime publike të qytetarëve,

1.9 Varrezat dhe hyrjet në varreza.

Neni 21

Rrugët

1. Rrugët janë sipërfaqe publike, të përcaktuara për komunikacion.

2. Rrugët duhet të mbahen në gjendje të rregullt dhe shfrytëzohen në bazë të destinimit.

3. Ndërmarrja e autorizuar për mirëmbajtjen e rrugëve lokale, është e obliguar që të gjitha dëmtimet nëpër rrugët e trafikut dhe trotuare, t'i evitojë si dhe t'i mbajë ato në gjendje të rregullt.

Neni 22

Kufizimi i lëvizjes në rrugët e asfaltuara

1. Në sipërfaqet e rrugëve të shtruara me shtresën e asfaltit, ndalohet lëvizja e të gjitha mjeteve transportuese dhe të tjera të cilat mund të dëmtojnë rrugën, siç janë: makinat me zinxhirë, llojet e ndryshme të makinave ndërtimore dhe mjetet tjera të ngjashme.

2. Transporti i makinave dhe i mjeteve tjera që e dëmtojnë rrugën, mund të bëhet vetëm me mjete transportuese të veçanta.

Neni 23

Njoftimi me rastin e ndërtimit ose rikonstruimin e rrugëve

1. Gjatë ndërtimit të rrugëve të reja ose rikonstruktimit të rrugëve ekzistuese, ndërmarrjet të cilat kujdesen për mirëmbajtjen dhe qeverisjen e pajisjeve komunale, si dhe qytetarët dhe organizatat të cilat në ato rrugë posedojnë objekte duhet të jenë të njoftuara së paku 1 muaj para fillimit të ndërtimit, rikonstruktimit që të përgatitet për vendosjen e pajisjeve komunale ose për lidhjen e objekteve të veta në këto pajisje.

2. Qytetarët dhe subjektet tjera me të cilat kanë të bëjnë dispozitat nga paragrafi paraprake janë të obliguar që mbi nevojat e kryerjes së punëve në pajisjet komunale dhe në lidhjet që të njëjtit ta njoftojnë investitorin i cili punon ose rikonstrukton rrugën, në mënyrë që vendosja e lidhjeve të bëhet para ndërtimit ose rikonstruktimit të rrugës.

Neni 24

Trotuaret

1. Trotuaret janë sipërfaqe publike të cilat shfrytëzohen për ecjen e këmbësorëve.

2. Të gjithë personat fizik dhe juridik, janë të obliguar që trotuaret, shiritat e rrugëve dhe sipërfaqet tjera publike t'i shfrytëzojnë në mënyrë si është rregulluar me këtë Rregullore.

3. Shkarkimi i mallit nëpër trotuare, bëhet vetëm atëherë kur kjo nuk mund të bëhet nëpër oborret e ndërtesave, respektivisht të hapësirave punuese.

4. Njëkohësisht malli duhet të largohet menjëherë nga trotuari, e më së voni në afat prej një ore pas shkarkimit të mallit.
5. Trotualet dhe sheshet e vogla, mund të shfrytëzohen për shkarkimin e mallit dhe të materialit për ngrohje vetëm me lejen paraprake të Drejtoratit për Shërbime Publike.
6. Nëse gjatë shfrytëzimit të këtyre sipërfaqeve shkaktohet dëmtimi i tyre, shfrytëzuesit janë të obliguar që ato t'i kthejnë në gjendjen e mëparshme, me shpenzimet e veta.

Neni 25 Terrenet sportive

1. Terrenet dhe fushat e sportit janë sipërfaqe publike të lira ku mbahen manifestimet sportive me qëllim të organizimit të garave dhe të argëtimit.
2. Terrenet sportive dhe objektet sportive, nuk mund të shfrytëzohen pa lejen paraprake të titullarit.
3. Terrenet për sport dhe argëtim (stadiumi, qendra sportive-rekreative, fushat e sportit dhe hapësirat e objektet e ngjashme) duhet të mirëmbahen dhe pastrohen rregullisht, për të cilat kujdesen organet, personat juridik dhe individët të cilët këto objekte i shfrytëzojnë dhe i mirëmbajnë.
4. Në hapësirat dhe objektet nga paragrafi paraprakë, duhet që në vend të dukshëm të vendosen në formë të shkruar udhëzimet higjienike dhe teknike mbi punë në këto hapësira dhe terrene.
5. Vizitorët janë të obliguar që t'u përmbahen udhëzimeve dhe dispozitave nga paragrafi paraprak.

Neni 26 Gjelbërimi publik

1. Me qëllim të ruajtjes dhe mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra dhe zgjerimit e kultivimit të këtyre sipërfaqeve në territorin e qytetit, vendbanimeve dhe fshatrave, ato në mbikëqyrje dhe në mbrojtje, në mënyrën si është përcaktuar me këtë Rregullore, parashihen:
 - 1.1 Sipërfaqet publike të gjelbra: rendet e drunjve, gjelbërimi i ambientit në lagjet e banimit, gjelbërimi afër rrugëve të trafikut, parqet, pyjet e të ngjashme,
 - 1.2 Sipërfaqet e gjelbra me destinim të veçantë dhe të dobishëm (gjelbërimi rreth varrezave, rreth objekteve kulturore historike dhe objekteve tjera me rëndësi),
 - 1.3 Sipërfaqet e gjelbra për sport dhe rekreacion (oborret e shkollave, ushtrimoret, terrenet sportive, qendrat, vendet për rekreacion e të ngjashme) dhe objekteve komunale,
 - 1.4 Gjelbërimi i vendeve për vikend, hapësirave të kampeve, lokaliteteve turistike dhe shetitoreve.
- 2 Dispozitat e kësaj Rregulloreje nuk kanë të bëjnë me pyjet, tokën bujqësore dhe pjesët e natyrës për të cilat aplikohen dispozita të veçanta.

Neni 27

Gjelbërimi dhe zgjerimi i sipërfaqeve të reja gjelbëruese

1. Gjelbërimi i sipërfaqeve në vendet e posandërtuara, parashihet me projektet e ndërtimeve të reja dhe bëhet me anë të kontrollit profesional të organit kompetent komunal.
2. Zgjerimi dhe ngritja e sipërfaqeve të reja, bëhet me anë të projektit mbi ndërtimin dhe rregullimin e sipërfaqeve të reja në harmoni me planin rregullues urban.
3. Shfrytëzimi i sipërfaqeve të gjelbra publike jashtë destinimeve të tyre themelore, mund të bëhet në rastet kur këtë e kërkon interesi publik, me pëlqimin/lejen e Drejtoratit për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 28

Mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbëruara

1. Punët rreth gjelbërimit, si kultivimi i drunjëve, mirëmbajtja dhe mbrojtja e sipërfaqes publike dhe sipërfaqeve tjera të gjelbra, në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, i kryejnë pronarët dhe ndërmarrja së cilës i besohen këto punë.
2. Ndërmarrja së cilës i janë besuar punët e mirëmbajtjes së gjelbërimit është e obliguar:
 - 2.1 Që menjëherë t'i largojë degët e dëmtuara për shkak të ndikimit të kushteve natyrore atmosferike ose nga shkaktarët tjerë,
 - 2.2 Që barin e kositur si dhe materialin e mbetur ta largojë nga sipërfaqet e gjelbëruara publike.
3. Degët e rritura të drunjve në sipërfaqet e gjelbra publike, të cilat pengojnë kabllot ajrore (rrjetin elektrik, telefonit e të ngjashme) duhet të shkurtohen ose të evitohen vetëm nga ana e ndërmarrjes së cilës i besohen punët dhe e cila është e obliguar që këtë ta bëjë me kërkesën e organit kompetent komunal apo të pronarëve të objekteve apo të hapësirave, nëpër të cilat kalojnë kabllot e ndryshme me kompensimin nga pronari i kablllove.
4. Të drejtat dhe obligimet lidhur me kryerjen e punëve nga paragrafi paraprak, do të rregullohen me kontratë.

Neni 29

Leja për vendosjen e instalimeve nëntokësore në sipërfaqet e gjelbra

Vendosja e instalimeve nëntokësore (objekteve të ujësjellësit dhe të kanalizimit, linjat elektrike, telefonike e të ngjashme) në sipërfaqet e gjelbra bëhet me lejen paraprake nga Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit me obligimin e investuesit që ta kthejë në gjendjen e mëparshme, sipas kushteve të përshkruara në leje dhe në projekt.

Neni 30

Mbajtja e pastërtisë dhe higjienës komunale në tregje dhe në objektet e tregjeve

1. Për mbajtjen e pastërtisë dhe të higjienës komunale nëpër tregje dhe objekte të tregjeve do të kujdeset pronari, respektivisht shfrytëzuesi i tregjeve.

2. Tregjet duhet të mbahen në gjendje të rregullt dhe të pastër. Pas kalimit të kohës së punës duhet të pastrohen, lahen dhe të jenë në gjendje të rregullt më së voni deri në ditën e nesërme në ora 12.

3. Ndërmarrja e cila menaxhon me tregjet, është e obliguar që në të gjitha tregjet të sigurojë sasi të mjaftueshme të ujit të rregullt higjenik të pijshëm për freskimin e prodhimeve dhe pastrimin e tregjeve, si dhe të ndërtojë numrin e caktuar dhe të nevojshëm të kabinave të njejve sanitarë, të cilat duhet rregullisht të pastrohen dhe të mirëmbahen dhe të vihet numri i mjaftueshëm i enëve, kontejnerëve për mbeturina dhe fundërrina, të cilat duhet të pastrohen rregullisht.

4. Në hapësirat e tregut ku bëhet shitja e kafshëve, duhet të sigurohet sasia e mjaftueshme e ujit higjenik për pije dhe ujit për kafshë, si dhe të ndërtohen njeje sanitare me numër të caktuar të kabinave, të ndërtohen vendet për lidhjen e kafshëve dhe vendosen enët për grumbullimin e mbeturinave dhe të fundërrinave, ndërsa hapësira e tregut pas çdo dite të tregut duhet të pastrohet mirë nga plehu dhe nga fundërrinat tjera dhe atë më së voni deri në ditën e nesërme në ora 12.

5. Hapësira e tregut për shitjen e materialit për ngrohje (dru, thëngjill), si dhe asortimenteve tjera nga druri, për shitjen e gëlqeres dhe të prodhimeve të ngjashme duhet të mbahet në rregull, në gjendje të pastër dhe pas çdo dite të tregut të pastrohet dhe atë më së voni deri në ditën e nesërme në ora 10.

Neni 31

Gropimi i sipërfaqeve publike

1. Ndalohet çdo gropim dhe çdo dëmtim i sipërfaqeve publike, me përjashtim për rastet e parapara me këtë rregullore.

2. Sipërfaqet mund të gropohen, në bazë të lejes së Drejtoratit për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, me rastin e vendosjes së rrjetit të ri të ujësjellësit, të kanalizimit, të rrjetit telefonik, elektrik të objekteve të sinjalizimit në trafik, pastaj lidhur me ndërlidhjen e ndërtesave dhe objekteve të tjera në rrjetë si dhe për mirëmbajtjen e instalimeve të këtyre objekteve (në tekstin e mëtejshmë pajisjet komunale).

3. Gjatë gropimit të sipërfaqeve publike vendi ndërtimor duhet patjetër të sigurohet në mënyrë të theksuar me shenja, rrethojë dhe masat tjera mbrojtëse në pajtim me dispozitat mbrojtëse në ndërtimtari.

4. Kryesi i punëve është i obliguar veçanërisht:

4.1 që gropimin ta kryejë sipas lejes së dhënë,

4.2 që vendi ndërtimor gjatë natës të jenë i ndriçuar,

4.3 që vendin ndërtimor ta rregullojë ashtu që të mundësohet qarkullimi pa pengesë i automjeteve dhe i këmbësorëve,

4.4 të shënohet vendi ku është lejuar, respektivisht ndaluar kalimi i automjeteve dhe këmbësorëve,

4.5 punët të kryhen në pajtim me të gjitha kushtet teknike, të cilat kanë të bëjnë me ndërtimin dhe rikonstruktimin e rrugëve dhe të shesheve.

5. Sipërfaqet e grupuara publike duhet menjëherë të meremetohen dhe të kthehen në gjendjen e mëparshme, sipas afatit të përcaktuar me lejen për gropim dhe të largohen të gjitha materialet nga vendi ndërtimor.

6. Nëse bëhet gropimi i trotuarit, kryesi i punëve është i obliguar që me mjete përkatëse të sigurojë kalimin mbi pjesën e gruposur të rrugës.

7. Kryesi i punëve është i obliguar që të sigurojë qasje pa pengesë dhe të sigurt në ndërtesat afariste dhe në lokale si dhe në ndërtesat banesore e objektet tjera.

8. Nëse në afatin garantues prej 1 viti nga dita e kryerjes së punimeve në sipërfaqet e grupuara paraqiten dëmtime, meremetimin e bartë investitori me shpenzimet e veta.

Neni 32

Leja për gropim në sipërfaqet publike

1. Për kyqjen, riparimin dhe mirëmbajtjen në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit, në rrjetin elektrik dhe telefonik e të ngjashme, mund të lejohet gropimi i shiritit të rrugëve dhe trotuareve me lejen e Drejtoratit për Shërbime Publike.

2. Leja për gropim të trotuareve, shiritit të rrugës dhe të sipërfaqeve publike, përveç kushteve të tjera, përmban edhe obligimin e shfrytëzuesve, respektivisht të investitorit, që shiritin e rrugës dhe trotuarin ta kthejnë në gjendje të mëparshme.

Neni 33

Gropimi në sipërfaqe publike në raste urgjente

1. Evitimi i prishjeve në rrjetin e ujësjellësit, kanalizimit, rrjetit të energjisë elektrike të objekteve të sinjalizimit në trafik dhe gropimi i sipërfaqeve publike, mund të bëhet nga ana e ndërmarrjeve të cilat kujdesen për këto pajisje dhe atë vetëm në raste kur kanë ngjarë prishjet dhe duhet urgjentisht të evitohen.

2. Në këtë rast, ndërmarrja e cila e ka bërë gropimin është e obliguar që menjëherë ose më së largu ditën e parë të punës ta njoftojë organin komunal kompetent për gropimin e sipërfaqes publike dhe njëkohësisht të kërkojë lejen për gropim.

3. Nëse inspektori kompetent vlerëson se evitimi i prishjes nga paragrafi 1 i këtij neni, nuk ka qenë i natyrës urgjente, konsiderohet se punët e kryera janë bërë pa leje dhe kryesi i punëve i bartë të gjitha pasojat.

Neni 34

Menaxhimi dhe ruajtja e sipërfaqëve publike

1. Komuna do të kujdeset që sipërfaqet publike të mos uzurpohen, të mos dëmtohen dhe të shfrytëzohen sipas destinimit të përcaktuar nga Komuna.

2. Për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike, Komuna me akte të posaqme do të rregulloj mënyrën e menaxhimit dhe shfrytëzimit të sipërfaqeve publike.

3. Bizneset dhe qytetarët e Komunës kanë për obligim që të mos uzurpojnë, dëmtojnë sipërfaqet publike dhe të mos i shfrytëzojnë ato pa lejen e organeve komunale.

Neni 35
Ndriçimi publik

1. Të gjitha rrugët kryesore të qytetit, por edhe në fshatra dhe vendbanime të tjera, gjatë natës duhet të jenë të ndriçuara, nëse për këtë lejojnë kushtet teknike,
2. Vendet e llambave elektrike për ndriçim publik, duhet të jenë të vendosura ashtu që mundësojnë ndriçimin e tërësishëm të rrugëve, sipas normativave të përcaktuara.
3. Llambat e djegura patjetër zëvendësohen me të reja.

Neni 36
Mirëmbajtja e ndriçimit publik

1. Për ndriçimin e rrugëve, ndërrimin e llambave të djegura dhe mirëmbajtjen e rrjetit ndriçues në gjendje të rregullt, do të kujdeset ndërmarrja të cilës i besohen punët e mirëmbajtjes së ndriçimit publik.
2. Të drejtat dhe obligimet e ndërmarrjes përcaktohen me kontratë.

Neni 37
Mbishkrimi dhe reklamat

1. Të gjitha subjektet që merren me biznes, janë të obliguara që të vendosin firmën në hapësirën punuese dhe atë ta vendosin në pjesën e jashtme të hyrjes kryesore të lokalit, në të cilën veprojnë dhe punojnë.
2. Format dhe madhësia e tyre duhet të jenë në pajtim me formën dhe madhësinë e fasadës dhe të hyrjes në banesë, lokale etj.
3. Mbishkrimi i firmës duhet të jetë i shkruar dhe i lexueshëm dhe në pajtim me çertifikatën e regjistrimit të biznesit.
4. Pronarët e firmave me mbishkrime dhe reklama ndriçuese, janë të obliguar që t'i mbajnë ato në gjendje të rregullt.
5. Në punishtet e objekteve në ndërtim e sipër të hapësirave punuese dhe në objektin i cili renovohet ose adaptohet si punues, duhet të vendosen mbishkrimet e firmave ndriçuese sipas dokumentacionit teknik të lejuar.
6. Pronarët, gjegjësisht shfrytëzuesit e hapësirave punuese janë të detyruar që mbishkrimet e firmave ndriçuese t'i mbajnë në gjendje të rregullt.
7. Kontrollin inspektues e bënë Drejtoria e Inspeksionit dhe nëse vërteton se mbishkrimi i firmës nuk është vendosur ose nuk është në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, do të marrë vendim me të cilën do të obligohet subjekti afarist që mbishkrimin e firmës ta vendos në atë mënyrë si është e paraparë me rregullore.

Neni 38

Ndërtesat dhe pamja e jashtme e tyre

1. Pamja e jashtme e ndërtesës (fasada, ballkoni, dyert, dritaret etj. pa marrë parasysh destinimin e tyre, shfrytëzimin apo pronësinë), patjetër duhet të mirëmbahen në pajtim me kërkesat estetike dhe pamjen e ndërtesës, ndërsa kushtet do t'i përcaktojë Drejtoria e Urbanizmit.
2. Pronarët e ndërtesave dhe shfrytëzuesit janë të obliguar që fasadat dhe detajet e fasadave (ballkonet, tarracat, ulluqet, tabelat dhe numrat e banesave e të ngjashme) të mirëmbahen, ngjyrosen, emalohen dhe të përgatiten, ashtu që gjithmonë të jenë në gjendje të rregullt dhe ta kenë pamjen e rregulluar.
3. Për pastërtinë dhe rregullimin e objektit nga paragrafi paraprakë, janë të obliguar të kujdesen shfrytëzuesit e banesave dhe shfrytëzuesit e tjerë të hapësirave në pajtim me dispozitat e rendit shtëpiak dhe të ndërtesave banesore, ndërsa për rregullimin dhe pastërtinë e pjesëve të jashtme të ndërtesave tjera, do të kujdesen shfrytëzuesit e hapësirave në ato ndërtesa ose ndërmarrja e cila drejton ndërtesën dhe pronarët e ndërtesës.
4. Oborret e ndërtesave dhe të lokaleve, duhet të mbahen në gjendje të pastër dhe të rregullt.
5. Drejtoria e Inspeksionit, me Vendim mund t'i urdhërojë personat përgjegjës për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe të rregullsisë së pjesëve të ndërtesave, që t'i eliminojnë mungesat dhe pengesat menjëherë apo në një afat të caktuar.

Neni 39

Mirëmbajtja në rrjetin e ujësjellësit, kanalizimit dhe ndriçimit në hapësirat e përbashkëta të banimit

1. Pronarët e ndërtesave dhe shfrytëzuesit e ndërtesave, janë të obliguar që personalisht ose me anë të ndërmarrjes së autorizuar për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe të higjienës, të ndërmarrin masa gjegjëse lidhur me pastrimin dhe mënjanimin e çfarëdo dëmtimi në linjën e ujësjellësi, kanalizimit dhe ndriçimit në hapësirat e përbashkëta në ndërtesë.
2. Nëse, në ndërtesë për shkak të prishjes së kanalizimit derdhen ujërat e zeza dhe ujërat fundërrinore, në lokalet e përbashkëta e të ngjashme, shfrytëzuesit-pronarët e lokaleve apo ndërtesave janë të obliguar, që me shpenzimet e veta t'i eliminojnë prishjet në rrjetin e kanalizimit dhe ujësjellësit.

Neni 40

Objektet jofunksionale

1. Ndërtesat dhe objektet e tjera të cilat nuk mund të shërbejnë për destinimin e vetë dhe japin një pamje jo të mirë, për arsye se janë vjetruar dhe mund të rrezikojnë ose paraqesin rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve, për trafik ose objektet fqinjë, duhet të rrënohen ose të mënjanohen.
2. Vendimin mbi rrënimin, respektivisht mënjanimin e merr inspektori komunal për punët e ndërtimit.

3. Nëse pronari, respektivisht organi qeverisës ose personi tjetër i autorizuar, nuk e rrënon ndërtesën, respektivisht objektin tjetër në afatin e caktuar me vendim, rrënimin do ta bëjë Drejtoria e inspeksionit dhe shpenzimet për këtë ia faturon obliguesit sipas vendimit.

Neni 41 Rrethojat

1. Të gjitha rrethojat duke i përfshirë edhe rrethojat e gjelbra, duhet të mirëmbahen në gjendjen e cila nuk e prishë pamjen e përgjithshme të asaj pjese të qytetit
2. Rrethojat e gjelbra duhet të mirëmbahen ashtu që mos të kalojnë vijën e rregulluar dhe të mos pengojnë trafikun publik. Deri te momenti i formimit përfundimtar të rrethojës së gjelbër mund të shfrytëzohet si mbrojtëse rrethoja ekzistuese

Neni 42 Gropat dhe pusetat në rrugë

1. Të gjitha gropat dhe pusetat e të ngjashme në rrugë, sheshe, oborre, bodrume, korridore dhe në vendet e ngjashme duhet të jenë të mbyllura.
2. Pusetat për ujësjellës dhe kanalizim, për kabllot elektrike dhe telefonike dhe të ngjashme gjithnjë duhet të ndërtohen dhe të mirëmbahen në gjendje të rregullt.
3. Për mirëmbajtjen e gropave, pusetave etj. nga paragrafi 1 janë të obliguar që të kujdesen pronarët, respektivisht shfrytëzuesit e pasurive të paluajtshme të cilëve u shërbejnë, ndërsa për gropat nga paragrafi 2 të këtij neni, janë të detyruara të kujdesen ndërmarrjet të cilat e ushtrojnë atë veprimtari.
4. Gropat dhe pusetat e të ngjashme të përfshira me këtë Rregullore, duhet të mirëmbahen rregullisht dhe të mbahen të mbyllura me mbulesë adekuate të sigurt.
5. Gjatë kohës së përdorimit, gropat duhet patjetër të rrethohen dhe të shënohen me shenjë që shihet mirë dhe sipas nevojës të mbyllen mirë që të mos e pengojnë sigurimin e kalimtarëve ose trafikut.

Neni 43 Shënimi i rrugëve dhe i objekteve

Për të gjitha çështjet të cilat lidhen me emërtimet e rrugëve, shtëpive, ndërtesave dhe banesave zbatohen dispozitat e Ligjit për Sistemin e Adresave.

Neni 44 Objektet publike dhe higjienike

Të gjitha ndërtesat, objektet hoteliere, (hotelet, motelet e të ngjashme) objektet për mbarëvajtjen e shfaqjeve, ligjëratave, hapësirat e klubeve, stacionet e autobusëve dhe objektet tjera të ngjashme, duhet patjetër të kenë më shumë nyje sanitare të ndërtuara në pajtim me dispozitat dhe kushtet higjienike-teknike.

Neni 45 Gropat Septike

- 1 Gropat septike duhet të gjenden jashtë ndërtesave dhe duhet të jenë të larguara nga muri i jashtëm i ndërtesës dhe të ndërtesës fqinjë më së paku 2 m.
- 2 Gropat septike mund të ndërtohen nga çimentoja, guri ose tullat dhe duhet të jenë patjetër të lyera me mallter çimentoje dhe të izoluara.
- 3 Gropat pa tjetër duhet të jenë të mbyllura hermetikisht me pllakë betoni, guri ose metali.
- 4 Gropat septike nuk mund të ndërtohen në trotuare dhe në sipërfaqe tjera publike.
- 5 Lejen për ndërtim e jep Drejtoria për Urbanizëm në bazë të pëlqimit të inspektorit sanitar.
6. Drejtoria e Inspeksionit, mund të urdhërojë me vendim, mënjanimin e nyjës sanitare dhe të gropës septike dhe jep urdhër që të ndërtohet e reja, nëse ajo nuk është ndërtuar sipas kushteve të parapara të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe nëse paraqesin rrezik për rrethinën në pikëpamje shëndetësore dhe higjienike.

Neni 46 Pastrimi i qytetit

1. Në interes të mbrojtjes së shëndetit dhe të sigurimit të kushteve higjienike në qytet dhe në para lagjet, rrugët, parqet, çerdhet e fëmijëve, oborret e ndërtesave familjare dhe afariste, trojet e lira dhe sipërfaqet tjera të hapura dhe të gjitha hapësirat e përbashkëta, duhet patjetër të mirëmbahen në gjendje të pastër sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.
2. Në mbajtjen e pastërtisë janë të detyruar të kujdesen qytetarët, ndërmarrjet, institucionet dhe, organizatat tjera.
3. Lidhur me mbajtjen e pastërtisë në kuptim të dispozitave të kësaj rregulloreje, përfshihen këto objekte:
 - 3.1 Rrugët, trotuaret dhe sheshet,
 - 3.2 Parqet,
 - 3.3 Shëtitoret, terrenet sportive dhe argëtuese,
 - 3.4 stacionet e autobusëve dhe vendqëndrimet e autobusëve në vijat urbane dhe ndërrurbane;
 - 3.5 Ambulancat, spitalet dhe çerdhet e fëmijëve;
 - 3.6 Varrezat, tregjet, shtrati i lumit dhe
 - 3.7 Hapësirat e hapura dhe të zbrazëta ndërmjet dhe rreth banesave, si dhe toka ndërtimore e pa ndërtuar (trojet e zbrazëta).

Neni 47 Obligimet për mbajtjen e pastërtisë

1. Për mbajtjen e pastërtisë në stacionet e autobusëve, të karburanteve si dhe objektet hoteliere, auto kampet dhe në vendet e ngjashme, janë përgjegjëse ndërmarrjet subjektet të cilat e kanë të drejtën e shfrytëzimit të këtyre objekteve.
2. Shfrytëzuesit nga paragrafi 1 i këtij neni janë të obliguar që në peronet, sallat e pritjes dhe në vendet tjera ku frekuentojnë njerëzit, në vendet e përshtatshme, të vendosin numër të mjaftueshëm të shportave për hedhjen e mbeturinave.

3. Nyjet sanitare publike, duhet mbajtur në gjendje të rregullt dhe të pajisura me mjete të nevojshme si dhe të dezinfektohen kohë pas kohe me mjete përkatëse.
4. Për mirëmbajtjen e pastërtisë në sipërfaqe publike janë të obliguar që të kujdesen pronarët dhe shfrytëzuesit e këtyre sipërfaqeve.
5. Pronarët dhe shfrytëzuesit e sipërfaqeve publike, punët mund t'i besojnë ndërmarrjes së specializuar për mbajtjen e pastërtisë në pajtim me procedurat e prokurimit.
6. Shfrytëzuesit e hapësirave afariste janë të obliguar që ato t'i mbajnë të pastra. Xhamat nëpër dritare dhe vitrina duhet të jenë gjithmonë të pastër dhe në gjendje të rregullt.
7. Banorët e fshatrave janë të obliguar t'i pastrojnë trotualet respektivisht pjesët e rrugëve para shtëpive të veta, oborret dhe sipërfaqet tjera përpara dhe rreth shtëpisë.

Neni 48 Pastrimi i rrugëve

1. Pastrimi i rrugëve duhet të bëhet sipas mënyrës dhe në kohën e cila e siguron efektin më të mirë të pastrimit dhe që në masën më të vogël pengon qarkullimin e kalimtarëve dhe zhvillimin normal të trafikut.
2. Larja e rrugëve mund të bëhet prej orës 24:00 deri në ora 5:00 të ditës vijuese.
3. Të gjitha automjetet para hyrjes në sipërfaqet publike të trafikut publik duhet patjetër të pastrohen nga balta dhe mbeturinat tjera.
4. Nga balta dhe papastërtia, patjetër duhet pastrohen edhe të gjitha mjetet bartëse para daljes në sipërfaqe publike, në trafikun publik nga shkarkimet, nga objektet ndërtimore dhe nga hapësirat tjera nga të cilat balta dhe papastërtitë tjera mund të bartën në sipërfaqe publike.

Neni 49 Pastrimi i borës

1. Për pastrimin e borës nga trotualet para ndërtesave banesore dhe afariste kujdesen pronarët dhe shfrytëzuesit e ndërtesave banesore dhe të lokaleve afariste.
2. Ndërmarrjet dhe qytetarët janë të obliguar që gjatë pastrimit të sipërfaqeve nga paragrafi 1 të këtij neni ta grumbullojnë borën dhe akullin në skaj të trotuarit, ndërsa ndërmarrja e kontraktuar për pastrimin e rrugëve është e obliguar që borën e grumbulluar në skaje të trotuarit ta bart menjëherë jashtë qytetit e më së voni brenda 24 orësh.
3. Ndërmarrja e kontraktuar, me rastin e reshjeve të mëdha atmosferike është e obliguar që nga rrugët, trotualet, trafikun publik dhe atij të dorës së dytë të kujdeset dhe rregullisht t'i pastrojë ato nga bora dhe akulli si dhe të hedhin kripë mbi to.
4. Ndalohet hedhja e borës dhe akullit në rrugë nga ana e qytetarëve dhe ndërmarrjet.
5. Në rastet kur gjatë ditës bie borë, trotualet sipas nevojës do të pastrohen edhe disa herë në ditë duke u angazhuar detyrimisht të gjithë qytetarët dhe ndërmarrjet, në rast se bora bie pandërprerë gjatë natës, e njëjta do të pastrohet në ditën e ardhshme e më së voni deri në ora 9:00 të mëngjesit.

III. NDALESAT

Neni 50 Ndalesat

Sipas dispozitave të kësaj rregulloreje ndalohet:

1. Gjatë shfrytëzimit të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit ndalohet:

- 1.1 hedhja e mbeturinave, hirit, çimentos, rërës e fundërrinave tjera të ngjashme në rrjetin shtëpiak të ujësjellësit dhe të kanalizimit, të cilat mund të shkaktojnë prishjen dhe dëmtimin e funksionimit të rregullt të pajisjeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit,
- 1.2 në përcjellësit e ujit të rrugëve të derdhen lëndët e ngurta e materiali tjetër,
- 1.3 që në ujëmbledhës të hedhen mbeturinat nga pastrimi i oborreve dhe shesheve,
- 1.4 derdhja në kanalizim të ujit dhe lëngjeve tjera të cilat mund të bëhen shkak i dëmtimit të gypave,
- 1.5 derdhja e ujërave fundërrinore pa lejen e ndërmarrjes së cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit,
- 1.6 parkimi i automjeteve apo vënia e materialit ose mbeturinave në dhe mbi objektet e ujësjellësit dhe të kanalizimit,
- 1.7 të bëhet çfarëdo dëmtimi në objektet e ujësjellësit dhe kanalizimit,
- 1.8 ndalohet ujitja e kopshteve – oborreve (gjatë kohës kur është e ndaluar konform nenit 18 par.3).

2. Në sipërfaqet e gjelbëruara publike ndalohet:

- 2.1 këputja, shkulja dhe prerja e drunjve dekorativ, barit dhe bimëve të tjera, thyerja e degëve apo fidanëve e të ngjashme,
- 2.2 vozitja dhe parkimi i automjeteve (i të gjitha llojeve) si dhe shkarkimi dhe deponimi i çfarëdo materiali në këto sipërfaqe,
- 2.3 dëmtimi i ulëseve, shportave, rekuizitave, kalimi për këmbësorë jashtë shtigjeve, hidrantëve dhe instalimeve tjera,
- 2.4 largimi, djegia, dëmtimi i shenjave dhe mbishkrimeve të vendosura me qëllim të mbajtjes së rendit,
- 2.5 shfrytëzimi i sipërfaqeve publike dhe të tjera të gjelbëruara jashtë destinimeve të tyre themelore ose kryerja e çfarëdo veprimtarie në to pa lejen e veçantë,
- 2.6 vendosja dhe derdhja e çfarëdo lënde dhe materiali nëpër drunj dhe në pjesët tjera, pa lejen e organit kompetent për punët komunale,
- 2.7 rrëzimi dhe zhvendosja e ulëseve, rekuizitave sportive, rrethojave e të ngjashme,
- 2.8 lëshimi i ujërave të zeza nëpër parqe dhe sipërfaqe tjera publike,
- 2.9 keqpërdorimi i ujit në fontana (hyrja në to, larja e personave dhe gjësendeve,
- 2.10 vendosja e luna - park, cirkut dhe rekuizitave tjera,
- 2.11 shfrytëzimi për kullosa të kafshëve dhe shpezëve,
- 2.12 ndezja e zjarreve dhe djegia e gjethëve në ambiente të hapura me qëllim ose nga pakujdesia,
- 2.13 hedhja e shtazëve dhe shpezëve të ngordhura dhe fundërrinave të tjera,
- 2.14 mihja, hapja e puseve, mbjellja e drunjve etj për çfarëdo destinimi, pa u pajisur me leje nga organi kompetent komunal.

3. Në rrjetin e ndriçimit publik ndalohet:

3.1 thyerja, djegia ose në mënyrë tjetër dëmtimi i poqave, instalimit elektrik publik, instalimeve elektrike, shtyllave, kablllove, rrjetit të telefonit, mjeteve izoluese, trafostacioneve etj.,

3.2 ndalohet kryerja e punimeve në dhënien e lidhjeve për pajisjet shtëpiake, apo çfarëdo lidhje tjetër nga rrjeti i ndriçimit publik, shtyllave të instalimeve tjera, si dhe kontakti me to i personave të paautorizuar.

4. Në objektet e përbashkëta të banimit ndalohet:

4.1 Ndalohet hedhja e mbeturinave në hapësirat e përbashkëta: korridore, shkallë, ashensor e të ngjashme,

4.1 Ndalohet lëshimi i ujit dhe të ngjashme për larjen e ballkoneve me qëllim të pengimit të fqinjëve apo të tjerëve,

4.3 Ndalohet lirimi i tymit, çagjës, avullit, kundërmimit të rëndë, gazrave toksike etj, nga ndërtesat, lokalet punuese, tymtarët, gjeneratorët etj, në afërsi të ndërtesave banesore dhe afariste shumëkatëshe, veçanërisht në afërsi të, ballkoneve, fasadave, dritareve, tarracave dhe hyrjeve në korridore e në shkallë,

4.4 Ndalohet kryerja e punimeve pas orës 19 deri në 8 të mëngjesit, si dhe në ditën e dielë dhe në ditët e festave.

5. Në terrenet sportive ndalohet:

5.1 kapërcimi i rrethojave të terreneve sportive dhe të qendrës sportive rekreative dhe hyrja në terren,

5.2 hipja ose mbështetja në rrethojat e terreneve sportive dhe të qendrave sportive dhe rekreative,

5.3 kullotja e bagëtisë në terrenet sportive dhe terrenet tjera sportive rekreative,

5.4 të gjitha veprimet tjera me të cilat dëmtohen terrenet sportive dhe qendrat sportive e rekreative.

6. Në sipërfaqet publike nuk është e lejuar pa lejen paraprake të Komunës si vijon:

6.1 Vendosja e qfarëdo objekti montazh apo ndërtimorë,

6.2 Dëmtimi i mjeteve, objekteve dhe pajisjeve të dedikuara për shërbime publike,

6.3 Vendosja e agregatëve dhe ambalazheve të ndryshme nga veprimtaria e biznesit në hyrje të banesave kolektive dhe individuale,

6.4 Rregullimi dhe larja e automjeteve,

6.5 Vendosja e automjeteve të prishura dhe që janë jashtë përdorimit,

6.6 Shitja e produkteve të ndryshme jashtë sipërfaqeve të tregjeve,

6.7 Vendosja e reklamave në shtyllat e komunikacionit, të ndriçimit publik dhe shtyllave elektrike dhe emërtimit të rrugëve,

IV. ZBATIMI I RREGULLORES DHE MASAT NDËSHKUESE

Neni 51

Zbatimi i Rregullores

Për zbatimin e Rregullores kujdeset Drejtorati për Shërbime Publike, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe mbrojtje të Mjedisit, dhe Drejtorati për Inspeksion.

Neni 52

Dënimet për kundërvajtje

1. Dënohet për kundërvajtje me gjobë prej dyqind e pesëdhjetë (250) € personi për shkeljet nga 7 par. 1 nën par. 1.1, 1.2 dhe 1.4.
2. Dënohet për kundërvajtje me gjobë prej treqind (300) € personi juridik për shkeljet nga neni 11.
3. Dënohet për kundërvajtje prej njëqind 100 € personi për shkeljet nga nenet 12.
4. Dënohet për kundërvajtje prej pesëdhjetë (50) € deri njëqind (100) euro personi për shkeljet nga nenet 15 par.15.4 dhe 15.5.
5. Dënohet për kundërvajtje me gjobë prej njëqind (100) € deri pesëqind (500) € personi për shkelje nga nenet 22 par.1, 30, 31, 32 dhe 33.
6. Dënohet për kundërvajtje me gjobë prej pesëdhjetë (50) € deri njëqind e pesëdhjetë (150) € personi për shkeljet nga neni 24 par. 3, 4 dhe 6.
7. Dënohet për kundërvajtje me gjobë prej njëqind (100) € deri treqind (300) € personi për shkeljet nga nenet 29, 34 par. 3, 39, 42 dhe 45.
8. Dënohet për kundërvajtje me gjobë prej pesëdhjetë (50) deri dyqind (200) € personi për shkeljet nga nenet 47, 50 par.1, 2, 3, 4,5 dhe 6 nën par. 1 dhe 2.

Neni 53
Dënimet mandatore

1. Për veprimet e ndaluara nga nenet 37, 48 par. 3 dhe 4, 49 par. 1, 2, 3, 4, neni 50 par. 5 dhe 6 nën par.3, 4, 5, 6 dhe 7 ndaj personave do të shqiptohet gjobë mandatore në lartësi prej njëzet (20) deri pesëdhjetë (50) €.
2. Ndaj personave të cilët gjobën mandatore nuk e paguajnë në afatin prej 8 ditësh do të ushtrohet fletëparaqitje për kundërvajtje.

V. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 54
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në faqen elektronike të Komunës.

15Nr. 011 - 41357
Lipjan me 01. 08. 2016

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

**Kryesuesja
Vlora Limani-Hajnuni**

